




REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Datë: 11 shtator 2026

Bazuar në Rregulloren (KKV) nr.08/20 për Dhënien e Dekoratave si dhe Planin e Punës së Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë – Qeverisë Komunale për vitin 2026, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Vushtrrisë, shpallë:

KONKURS LETRAR TË POEZISË

PËR FESTIVALIN

“TAKIMET E POETESHAVE SHQIPTARE 2026”

Komuna e Vushtrrisë do të organizojë edicionin e **44-të** të Festivalit **“Takimet e Poeteshave Shqiptare 2026”**, në të cilën inkurajohen, që me poezitë e tyre të konkurrojnë krijueset shqiptare nga të gjitha trojet shqiptare, përfshirë edhe poetet nga mërgata.

Qëllimi i konkursit

- Ruajtja, kultivimi dhe zhvillimi i kulturës dhe letrave shqipe të femrat shqiptare;
- Nxitja, motivimi dhe promovimi i krijueseve shqiptare.

Kushtet për pjesëmarrje

- Poetet të konkurrojnë me emër dhe mbiemër dhe të jenë të moshës mbi 18 vjeçe,
- Poetet të konkurrojnë vetëm me nga një poezi,
- Format i shtypit dhe shkronjave duhet të jetë: Microsoft Word, Time New Roman, 12,
- Poezitë duhet të jenë në gjuhën shqipe, të pabotuara më parë.
- Poezitë të dërgohen vetëm përmes postës elektronike në adresën **poetetshqiptare@gmail.com** (Secilës poete i konfirmohet me kohë pranimi i poezisë përmes postës elektronike).
- Poetet, së bashku me poezitë e tyre sugjerohet t'i dërgojnë edhe dy numra kontakti (të qasshëm në çdo kohë), një biografi të shkurtër të krijimtarisë së poetes dhe një foto portret.
- 21 poetet që do të përzgjidhen për të vazhduar në fazat e mëtejme të konkurrimit do të njoftohen me kohë për detajet tjera në lidhje me organizimin e festivalit.

Afati i dërgimit të poezive:

- Afati i dërgimit të poezive është i hapur deri më 28 shtator 2026.

Poezitë e arritura do të grumbullohen në dosje nga një zyrtar i DKRS-së, i cili çdo poezie të pranuar do t'ia vendosë shifrën e koduar, duke ruajtur autorësinë dhe pas mbylljes së afatit për pranim të poezive, poezitë i dërgohen për vlerësim jurisë profesionale, të koduara dhe pa emra të autoreve. Poezitë do të vlerësohen nga një juri profesionale, e cila do të bëjë vlerësimin e poezive brenda një afati të arsyeshëm, pa pasur dijeni mbi autoren, por vetëm në bazë të shifrës, të cilën ia vendosë zyrtari i DKRS-së. Juria do të përmbyllë procesin e vlerësimit para datës së mbajtjes së festivalit, ndërsa ndarja e çmimeve do të bëhet në ditën e mbajtjes së festivalit. Për pjesëmarrje në festival do të kontaktohen vetëm poetet, poezitë e të cilave janë për zgjedhur për të vazhduar në fazën e dytë të konkurrimit, pasi të caktohet data e mbajtjes së festivalit nga Këshilli Organizues.

Poetet që do të vazhdojnë konkurrimin do të njoftohen përmes telefonit, pas vlerësimit të poezive nga ana e jurisë profesionale, ndërsa ato poete që nuk ftohen do të thotë që poezitë e tyre nuk janë përzgjedhur nga juria për të vazhduar më tutje.

Në këtë festival, në bazë të rregullores komunale, do të ndahen këto çmime për poezi:

Çmimi i parë.....	500 €
Çmimi i dytë	300 €
Çmimi i tretë	200€
Debutuesja (poetja më e re në moshë dhe që merr pjesë për herë të parë).....	100 €

Për të gjitha poetet, poezitë e të cilave do të përzgjidhen nga juria, për pjesëmarrje në festival, organizatori mbulon shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit.

Për informata më të hollësishme në lidhje me festivalin mund të kontaktoni në:

E-mail; poetetshqiptare@gmail.com

Tel: +38344406941

